



Raport i vitit 2015

Përmbajtja

Projektet e realizuara gjatë 2015-ës

Projekti 1 (Pakot ushqimore).....	2
Projekti 2 (Bursat).....	3
Projekti 3 (Projekti ishtëpisë).....	3
Projekti 4 (Puntorët).....	4
Projekti 5 (Manifestimi).....	4
Buxheti gjatë vitit 2015.....	5

GARANA

07.03.2016

Shoqata Humanitare

Raport i përgjithshëm mbi projektet e „Shoqatës Humanitare Garana“ në vitin 2015

Të nderuar antarë dhe bashkëatdhetarë

U bënë më shumë se katër vite që nga themelimi i Shoqatës. Atëherë nisëm një rrugëtim të përbashkët, që në mërgim të kemi një Shoqatë për fshatin tonë të dashur. Sot, mbas katër vitve, të gjithë bashkarisht, kemi arritur që Shoqata tani më të jetë një institucion i besueshëm dhe i vyshëm në mesin tonë. Kjo është edhe një dëshmi më shumë që, kur bashkohen forcat dhe qëllimi është i njëjtë, krijohen gjëra të mrekullueshme.

Edhe në vitin 2015, Shoqata ka patur një aktivitet të zgjëruar.

Në vijim keni një rradhitje të projektve gjatë vitit 2015.

1. Shpërndarja e pakove ushqimore

Ky projekt është i një rëndësie të veçantë për Shoqatën, dhe që nga fillimi Shoqata këtë projekt e ka kryer dy herë në vit. Me kërkesë të anëtarve, Shoqata morri vendimin që në vitin 2015, të shpërndahen tre herë pako ushqimore në vit. Numri i pakove mund të ndryshoj, Shoqata kujdeset që krejt ata që kanë nevojë të përfshihen në këtë projekt.

Realizimi i projektit(2015)

- Shpërndarja e parë: 13 pako ushqimore
- Shpërndarja e dytë: 13 pako ushqimore
- Shpërndarja e tretë: 13 pako ushqimore

Ky projekt, në vitin 2015 ka kapur koston e 4500 Fr.

GARANA

2. Bursat për studentët e Garanës

- Shoqata Humanitare Garana, me mbështetjen e plotë të antarëve, nga fillimi i vitit 2013 filloj me përkrahjen e tre studentëve apo studenteve të shkëlqyshëm. Përzgjedhja e Studentëve u bë me anë të një konkursi publik. U përzgjodhën kandidatët të cilët i plotësuan të gjitha kushtet e vendosura nga ana e Shoqatës. Secili student apo studente përfitojnë shumën prej 1000Fr. për vit akademik.
- Gjatë vitit 2015, dy nga studentët i përfunduan studimet me sukses të lartë. Shoqata momentalisht mbështet dy student/e.
- Shoqata do të vazhdojë edhe në të ardhmen të mbështesi student të shkëlqyer, nga se ata gjenerata të mirë edeukuara janë një vlerë e shtuar për të gjithë ne.

Realizimi i projektit (2015)

Bursat u dorëzohen Studentve dy herë në vit(në fillim të semestrit akademik)

- Semestri i parë: 4 Student/e = 2000 Fr.
- Semestri i dytë: 2 Student/e = 1000 Fr.
- Shuma totale për këtë projekt = 3000Fr.

Për vitin akademik 2014/2015, Shoqata ndau bursa për katër student/e.

3. Ndërtimi i Shtëpisë

Në mbledhjen e fundit të vitit 2014, më antarët e Shoqatës dhe bashkatdhetarët, e mbajtur më 23. Nëntor 2014 në Aarburg, të pranishmit mbështetën njëzëri, iden e propozuar nga ana e kryesisë, për ndërtimin e një shtëpie për djemt e Muhamedit, Ismailin dhe Imerin. Të pranishmit vendosën që buxheti i shoqatës të mos ngarkohet, mjetet e novjshme të mblidhen në menyrë vullnetare nga të gjith bashkatdhetarët të cilët duan të kontribuojn në këtë projekt.

Realizimi i projektit

Ashtu si u kërkua nga anëtarët, buxheti i Shoqatës nuk u përdor për këtë projekt. Të gjitha mjetet u grumbulluan nga kontributi i madh i shumë njerzve. Gjithashtu, gatishmëria e të gjithë firmave për të ndihmuar ishte shumë e lartë. Bashkë me Shoqatën „Garana e Bashkuar „, në Amerikë, ne ia arritëm të grumbullonim mjetet e nevojshme për ndërtimin e shtëpisë.

Gjithsesi u grumbulluan 26090 Fr.

Në fund të Nëntorit projekti u përfundua, dhe Ismaili me familjen e tij u transferua në shtëpinë e re.

Planin e detajuar me të gjitha kostot e këtij projekti mund ta gjeni në webfaqen tonë.

4. Mirmbajtja e varrezave dhe rrugëve të fshatit

Gjithashtu në mbledhjen e vitit 2014, në Aarburg, më antarët e Shoqatës dhe bashkatdhetarët, të pranishmit mbështetën njezëri, iden e propozuar nga ana e kryesisë, për të punësuar dy puntor nga Garana, të cilët do të mirmbajnë të gjitha varrezat e fshatit dhe do të kujdesen për rrugët.

Ky projekt tani funksionon gati se një vit.

Ky projekt realizohet në bashkpunim me Shoqatën në Amerikë, secila merr pjesë me 50% në këtë projekt.

Për përzgjedhjen e puntorve u shpallë konkurs. Të drejtë konkurimi kishin të gjithë banorët e fshatit Garanë. Në bazë të rregullave të përcaktuara me konkursin u zgjodhën edhe dy puntorët.

Rroga e paraparë vjetore është 3000 Franga në vjet për cdo puntor.

5. Organizimin e Manifestimit

Me 2015 SH.H.Garana organizoi manifestimin e tretë rradhasi. Edhe në këtë manifestim ishin të pranishëm artistë nga fshati jonë si, Dervish Dervishi, Argëton Dervishi dhe Rabie Rika. Atmosfera familjare dhe takimi me bashkatdhetarët e fshatit tonë e bëjnë të domosdoshëm organizimin e këtij manifestimi edhe në vitet tjera.

Gjithashtu duhet falimnderuar shumë vullnetarë të cilët ndihmojnë në mbarvajtjen e manifestimit. Të gjithëve anëtarëve u dërgua ka një DVD me incizimin e manifestimit.

Raport mbi të hyrat dhe daljet në vitin 2015

Kontabiliteti 2015	Hyrje CHF	Dalje CHF	Shuma Totale CHF
Antarsia	12.010.00 Fr.		
Sponzorat	3600 .00 Fr.		
Ndihmat		7400.00 Fr.	
Te ndryshme		6450.00 Fr.	
Total	15.610.00 Fr.		
Total-Dalje		13.850.00Fr.	
Shuma Totale			<u>1760.00. Fr.</u>

Informata më të detajuara rreth të gjitha projekteve mund të merrni te përfaqsesi juaj kantonal.

Shoqata do të angazhohet që, të gjitha projektet e filluara deri tani edhe në të ardhëmen të realizohen me kujdesin maksimal.

Me respekt dhe sinjeritet

Kryesia e Shoqatës Humanitare Garana